

**AKT - THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“ROAN – TRANS” SHPK**

Sot me dt 20.tetor 2015 (dymije e pesëmbëdhjete) , une ortaku I vetem :

Gezim Thartori , I biri I Lulezim , dhe I Shkendies , lindur me 30.04.1975 , ne Rrogozhine /Durrës , me vendbanim ne Durrës , Lagj.1 . Rruga “Ulliri Celislamit “ , madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar .

bazuar ne Ligjin 9901 date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite Tregtare “

**Vendosa**

Hartimin e Statutit te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar “ ROAN – TRANS “ SHPK , ne perputhje Me dispozitat e ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare “ .

**NENI 1**  
**EMERTIMI I SHOQERISE**

Shoqeria tregtare do te quhet ‘ROAN=TRANS’ shpk .

**NENI 2**  
**FORMA E SHOQERISE**

Shoqeria “ROAN’TRANS” shpk eshte e llojit Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar , me ortak te vetem , E krijuar dhe e zoteruar nga une Ortaku I vetem Gezim Thartori .

**NENI 3**  
**QENDRA (SELIA) E SHOQERISE**

Shoqeria “ROAN-TRANS “ shpk do te kete qendren (seline ) Durrës , Lagja 15 , Rruga Miqesia , Kapanon 1 katesh , Zona Kadastrale 8511 , Nr. Pasurie 147/16 , Durrës .

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj me vendim te Ortakut te vetem te Shoqerise .

Me vendim te ortakut te vetem Shoqeria mund te hape dege dhe /ose zyra te tjera perfaqesimi , ne Perputhje me legjislaionin ne fuqi .

**NENI 4**  
**KOHEZGJATJA E SHOQERISE**

Shoqeria “ROAN-TRANS” shpk do te veproje per nje periudhe kohore me shume se 10 vjet .

Me vendim te ortakut te vetem ky afat mund te jete me I shkurter apo mund te zgjatet me tej .

## **NENI 5** **REGJIMI JURIDIK**

Ne te gjithë territorin e saj ne Republiken e Shqiperise , Shoqeria do te udhehiqet nga legjislazoni Shqiptar ne fuqi .

Shoqeria gezon mbrojtjen dhe sigurim te plote ne perputhje me legjislazonin shqiptar ne fuqi . Per evidentimin e veprimtarise se Shoqerise do te perdoren dispozitat ligjore ne fuqi dhe kerkesat e pergjithshme te kontabilitetit , sic sqarohet me hollesishte ne dispozita perkatese te Statutit te Shoqerise qe I bashkangjitet ketij akti .

Shoqeria gezon afirmimin ligjor qe nga dita e rregjistrimit te saj ne QKR .

## **NENI 6** **OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

Objekti I veprimtarise se shoqerise do te jete :

- Import-eksport te materialeve industrial e , materialeve te ndertimit , artikuj ushqimor , produkteve te ndryshme bujqesore , blegtorale e fruta-perime , prodhimeve te detit , pijeve freskuese , te miellit dhe nenprodukteve te tij , pajisje elektroshtepiake , hidraulike dhe hidrosanitare etj , pjese kembimi per automjete dhe per mjete te tonazhit te larte si dhe tregetimi I tyre me shumice dhe pakice , si dhe eksportimin e skrapit dhe mbetjeve plastike(materialeve te riciklueshme ) .
- Transport kombetar dhe nderkombetar te mallrave te ndryshme si dhe te udhetareve .
- Krijimi I agjensive turistike ,hapje dhe shfrytezim hotelesh , motelesh , bar – kafe , restorantesh, qendra pushimi e kurative , qendra fitnesi , agjensive imobiliare , shkembim , blerje , shitje , dhenie me qera , menaxhimin ,administrimin e pasurive te paluajtshme te veta , te te treteve ose te dhena me qera financiare , si civile , tregtare ashtu dhe ato industriale , edhe te mobiluara , lidhja e kontratave te siper marrjes si dhe zhvillimi I te gjitha aktiviteteve te lidhura direkt ose indirekt me aktivitetin e ndertimit dhe ate qe ka lidhje me pasurite e paluajtshme ne pergjithesi , perفشire aktivitetin e ndermjetesimit ne lidhje me pasurite e paluajtshme .
- Germime dheu me punime eventuale muratore e beton – arme .
- Prodhim material inerte – gure .
- Ndertime civile dhe ekonomike .
- Ndertim rruge kategorise IV dhe V. Ndertim rruge kat.III, dhe II – I .
- Punime te mirembajtjes dhe sinjalizimit ne ruge , ndertim mbi shtresa rrugore .
- Punime hekurudhore .
- Ndertim ura dhe vepra arti – Estakada – ura metalike – te varura .
- Ndertim ujesjelles – kanalizime – kanale e impiante vaditje , ndertim ujesjellesi –kanalizime
- Punime mbrojtje te sistemit hidraulik .
- Punime karpentierie . instalim I impianteve higjenike , kuzhina , lavanteri , hidrosanitare – mirembajtja e tyre .
- Punime bojatisje – hidroizolim –termoizolim –akustike – kundra zjarrit
- Mirembajtje zhvillimi I dekorit ne mjediset urbane .
- Projektim per objekte civile – industriale – turistike prej murature e skelet beton arme , deri ne 5 kate .

- Gjithashtu shoqëria ka si objekt veprimtarie :pastrim , gjelberimin , grumbullimin e mbetjeve plastike , skrapit , mbetjeve të rrobaqepesise dhe mbetjeve spitalore si dhe asgjësimin e tyre , mbetjeve industriale dhe të inerteve .
- Shërbimin e serviseve për heqjen e mbeturinave dhe vajrave .
- Shërbim nëpër autoritetet portuale për pastrimin e ujërave detare të akuariumit nga ndotja dhe pastrimin e ujërave të zeza . Pastrim të ambienteve të brendshme spitalore dhe institucioneve t, plazheve private .
- Veprimtarinë e shërbimeve Katering (prodhim , përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve ) .
- Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të saj .

### **NENI 7**

#### **KAPITALI I SHOQËRISE**

Kapitali fillestar i shoqërisë është 100.000 (njëqindmijë ) leke , i barabartë me një kuotë me vlerë 100.000 (njëqindmijë) leke .

Kjo kuotë është prone tërësisht e Ortakut të vetëm të shoqërisë . dhe pas regjistrimit në QKR do të depozitohet në një bankë të shkallës së dytë .

Kapitali i shoqërisë do të rritet krahas ekurisë së saj ekonomike , financiare dhe të vendimeve që do të marrin Ortaku i vetëm në të ardhmen .

Në rast vdekje të Ortakut të vetëm të Shoqërisë , pasuria u kalon trashëgimtareve të tij sipas legjislativës në fuqi në Republikën e Shqipërisë .

### **NENI 8**

#### **DREJTIMI I SHOQËRISE**

Fillimisht shoqëria do të drejtohet , administrohet nga administrator Z. Gezim Thartori për një periudhë 5 (pese) vjetë me të drejtë përsëritje , i cili do të jetë drejtues ligjor i saj , si dhe do të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhëniet me të tretet .

Krahas ekurisë së veprimtarisë së shoqërisë , një ortak i vetëm i saj do të vendosë zgjerimin e organeve të ndryshme të drejtimit dhe të administrimit ekonomik .

Për çdo çështje profesionale , juridike , ekonomike , teknike , etj , shoqëria do të angazhojë sipas rastit në mënyrë të vijueshme ose të perkoheshme duke përdorur specialistët , drejtuesit teknik , etj , sipas legjislativës në fuqi .

### **NENI 9**

#### **SIGURIMI I PASURISË SË SHOQËRISE**

Pasuria e shoqërisë do të sigurohet në Institutin e Sigurimeve të Republikës së Shqipërisë si dhe në institute të tjera private ekzistuese , apo që do të krijohen në të ardhmen sipas legjislativës në fuqi .

Masa e pasurisë që do të sigurohet si dhe koha e sigurimit të saj do të vendoset nga një ortak i vetëm i shoqërisë .

**NENI 10**  
**BILANCI I SHOQERISE DHE DIVIDENTET**

Bilanci kontabel vjetor , miratohet mbi bazen e vendimit me shkrim te ortakeve , I cili jo vetem qe dokumenton miratimin e tyre por vendos ne lidhje me disponibilitetin e fondeve ligjore sipas nevojave te zhvillimit te metejshem te shoqerise dhe garantimin e veprimtarise se rregullt te saj , duke pasur parasysh fondin e akumulimit , krijimin e fondit te vecante , krijimin e reserves Ligjore . Rezerva Ligjore krijohet vit pas vitit nepermjet lenies menjane te nje shume te barabarte me 5% te fitimit neto te kapitalit themeltar te shoqerise .

Brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit financiar , Mbledhja e Asamblese se Ortakeve , miraton bilancin e paraqitur nga Administratori .

Mbledhja e asamblese se ortakeve vendos rreth shperndarrjes se dividenteve , pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financiar , sic edhe parashikohet nga ligji , ne raport me kuotat e zoteruar nga secili prej ortakeve .

**NENI 11**  
**LIKUJDIMI I SHOQERISE**

Rastet e likujdimit te shoqerise si dhe ai I mbarimit te afatit te aktit te Themelimit te shoqerise , do te jen ato qe pasqyrohemn ne legjislazonin ne fuqi ne republiken e shqiperise .

**NENI 12**  
**DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

Ky Akt per themelimin e shoqerise ka si pjese te tij edhe Statutin e shoqerise I cili bashkengjitet dhe depozitohet sipas dispozitave ligjore ne fuqi .

Ne rastet e likujdimit perfundimtar te shoqerise , sipas legjislazonit ne fuqi , pushon se vepruari edhe ky Akt – Themelimi .

Cdo ndryshim apo shtese qe mund ti behet ketij Akti per Themelimin e saj duhe te behet me shkrim , te nenshkruset nga une ortaku I vetem I shoqerise dhe te depozitohet si ne dokumentat e shoqerise qe mbahen ne Qendren e saj , ashtu si dhe ne QKR .

Ky Akt-Themelimi I shoqerise u lexua dhe u printua ne kater kopje dhe u neshkrua nga une Ortaku I vetem I shoqerise “ROAN-TRANS” shpk , Gezim Thartori , me vullnet te lire dhe te plote .

**ORTAKU I VETEM I SHOQERISE “ROAN – TRANS “ shpk**  
**GEZIM THARTORI**

